



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**BROSHURË PËR MËSUESIT DHE
PËR DREJTUESIT E SHKOLLAVE**



SHKOLLA TË SIGURTA

OFICERËT E SIGURISË NË SHKOLLA



Një program për sigurinë në shkollë

Siguria në shkollë është një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative, si brenda ashtu edhe jashtë mjediseve të shkollës. Lufta kundër dukurive të tilla, si episode të dhunës, përdorimi i drogave dhe substancave abuzive, dukuria e bullizmit, siguria fizike në shkollë etj., janë prioritet i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve dhe i Ministrisë së Brendshme.

Qëllimi i kësaj iniciative të përbashkët është garantimi i një mjedisi të nxëni të sigurt për nxënësit, stafin dhe komunitetin e shkollës. Përfshirja e oficerit të sigurisë në shkollë synon rritjen e sigurisë përmes mbështetjes dhe ndërveprimit me aktorët e shkollës.



Përfitimet e programit për shkollën

- » Rrit sigurinë në shkollë dhe përreth saj.
- » Vendos theksin në zgjidhjen e problemeve dhe në parandalimin e tyre.
- » Siguron përgjigje të shpejtë ndaj problemeve/çështjeve dhe zgjidhje të vazhdueshme të tyre.
- » Nxit ndërveprimin e nxënësve dhe të rinjve me policinë, si dhe rrit besimin dhe komunikimin me të.
- » Siguron formën më të mirë të mundshme të policimit të komunitetit.

Çfarë janë oficerët e sigurisë në shkollë?

Oficerët e sigurisë në shkollë janë burime të vlefshme të shkollave për krijimin e një mjedisi të sigurt, përmes ndërtimit të marrëdhënieve të forta e të qëndrueshme me nxënësit, stafin e shkollës, prindërit dhe komunitetin. Ato janë të përgatitur dhe të trajnuar për të përmbushur rolet e tyre.

Oficerët e sigurisë në shkollë përmbushin disa role.

Si oficerë të zbatimit të ligjit:

- » parandalojnë dhe menaxhojnë rastet e krimit dhe të dhunës në shkollë, duke kontribuar në ndërgjegjësimin e nxënësve për rregullat, autoritetin dhe drejtësinë;
- » punojnë ngushtë me drejtorinë e shkollës dhe me stafin e saj për parandalim dhe ndërhyrje në rastet e thyerjes së disiplinës, për menaxhimin e krizave dhe në rastet e emergjencave etj.;
- » shërbejnë si urë lidhëse ndërmjet policisë, të rinjve dhe shkollës.

Si këshillues për ligjin dhe sigurinë:

- » shërbejnë si partnerë dhe këshillues të administratës së shkollës;
- » evidentojnë, raportojnë dhe, në bashkëpunim me psikologun e shkollës ndërmjetësojnë situata konfliktuale brenda mjediseve të shkollës;
- » u ofrojnë prindërve asistencë për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe për menaxhimin e konflikteve.

Si edukatorë:

- » marrin pjesë në takimet me prindër dhe në takime periodike të stafit pedagogjik të shkollës për evidentimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve për sigurinë në shkollë;
- » në mënyrë periodike, zhvillojnë leksione ose biseda me nxënësit, me qëllim ndërgjegjësimin rreth dukurive dhe kërcënimeve të mundshme, si dhuna, substancat narkotike, trafikimi, siguria fizike nga zjarri etj.;
- » shërbejnë si modele rolesh pozitive për nxënësit dhe edukojnë vlerat e sistemit tonë ligjor.



